



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
NJËSIA E PROKURIMIT**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje pajisje te ndryshme zyre**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39120000-9 -  
Tavolina, dollapë, tavolina pune dhe rafte librash,

VLERA E FONDIT LIMIT: **5,786,700** (pesëmilion e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e shtatëqind) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Shkodër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga*

*autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

1. *Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 9).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2021, 2022 dhe 2023) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës e përkatësisht **2,314,680** (Dymilion e treqind e katermbedhjetemije e gjashtëqind e tetedhete) lekë.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila paashikon se Autoriteti koontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 41, pika 5/ c), nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar në neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për QKR”, i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrorjnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit në një vlerë prej **1,157,340 (Njemilion e njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzet) lekë, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jete afër limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës është nën kufirin e ulët monetar, vlera për furnizime të ngjashme prej **1,157,340 (Njemilion e njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzet) lekë** përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për **muajin e fundit** duhet të jetë **6 (gjashtë)**.

Lidhur me këte pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vertetimin të lëshuar nga Dega e Tatimit Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjësve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatëse E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në vendosjen e numrit minimal të punonjësve është bërë një analizë bazuar në faktorët, si prodhimi grafik i lëvrimin të mallrave, transporti, montimi, zhvendosja dhe sistemimi i tyre në ambientet e zyrave, riparimi dhe çdo proces tjetër përgjatë periudhës së garancisë. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë jep siguri dhe besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën brenda afatit dhe me cilësi.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik, e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Gjykojmë se është e domosdoshme që operatorët ekonomikë të disponojnë një staf të mjaftueshëm prej 10 (dhjete) punonjës, që do të që do të angazhohen për të përmbushur me sukses dhe në kohë kontratën brenda një periudhe prej 45 ditësh, bazuar në zërat e preventivit volumin/sasitë dhe specifikimet teknike të pajisjeve që nevojiten për tu furnizuar, montuar dhe vendosur, të cilët do të angazhohen në gjithë procesin e porositjes, furnizimit, magazinimit dhe transportimit të mallrave ku do të instalohen në objekt si dhe të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Këtu bëjnë pjesë marangoz/tapicier/montator dhe punonjës ngarkim/shkarkimi dhe gjithë stafi teknik dhe drejtues.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata

tatimore, shoqëruar me listpagesat është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpriqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, gjithashtu, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën **Sistemet e menaxhimit të cilësisë ISO 9001- 2015 ose e perditesuar** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë **ISO 45001-2018, ose e perditesuar** Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

**Argumentim:** Në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit të 79, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nga ana e AK është kërkuar zotërimi i certifikatave:

ISO 9001- 2015 - Sistemet e menaxhimit të cilësisë

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin pajisjet e mobiljeve për shkollat me qëllim furnizimin me pajisje cilësore nisur nga kohëzgjatja e konsiderueshme që përdoren këto pajisje, vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet dhe perben një garanci nga ofertuesi për cilësinë e mallrave dhe suportin teknik mbështetës që do të përdoren gjatë ekzekutimit të kontratës. Është një kërkesë gjerësisht e njohur dhe e përdorur në prokurimet publike ku cilësia e mallrave të fabrikuar dhe montimit të tyre është element preferencial i zbatimit të kontratës

ISO 45001-2018 - Certificate per menaxhimin e sistemit te sigurise dhe shendetit perfaqeson nje kerkese bazike te domosdoshme , e normatizuar edhe nga Kodi i punes i RSH dhe vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm dhe në përputhje të plotë me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

**2.3.5** Operatorët ekonomikë, që janë prodhues të mallrave objekt prokurimi, duhet të paraqesin kataloge/foto ose skeda teknike për mallrat që oferton, duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga mallrat e ofruara, sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse në DST, ne gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, të mallrave objekt prokurimi. (Katalogu/foto ose skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të çdo malli objekt prokurimi, me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e produkteve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4 të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që me paraqitjen e katalogut të bëhet i mundur një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara, për të përmbushur kontratën Autoriteti kontraktor synon verifikim e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë ofertues me ato të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit.

*“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë...”*

**2.3.6** Në rastin kur OE nuk është prodhues i këtyre produkteve/ artikujve, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë:

- Autorizim Prodhuesi ose Autorizim Distributori, për pajisjet e ofruara.  
Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.
- Kataloge/foto ose skeda teknike për mallrat që oferton, duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga mallrat e ofruara, sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse në DST, ne gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, të mallrave objekt

prokurimi. (Katalogu/foto ose skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të çdo malli objekt prokurimi, me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e produkteve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe në nenin 40, pika 8, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Kjo kërkesë është përcaktuar me qëllim që të sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratës, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, si dhe përfshirjen dhe suportine prodhuesit, përmes vet atij apo distributorit të autorizuar.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën 1-vjeçare të garancisë së mallrave që kërkohen të prokurohen nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, transportimin, mirëmbajtjen, zëvendësimin dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. 11 Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.



- 2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit, si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve objekt prokurimi.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter vendoset në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet pasi mallrat objekt prokurimi duhet të transportohen dhe montohen në të gjithë zyrat e përcaktuara në plan shpërndarje.

- 2.3.9** Operatori ekonomik prodhues/tregtar duhet të disponojë 1 (nje) mjet transporti me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton të përshtatshëm për transport mobiljesh. Mjeti i transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit (e vlefshme).
- Për mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.

- Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit  
*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumenti:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Referuar specifikimeve është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë venddorezimit të tyre në destinacionin përkatës, pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi. Eshtë kërkuar një kamion të përshtatshëm për transport mallrash për të vërtetuar që ofertuesit pjesëmarrës kanë automjete të nevojshme për transportin e mallrave, kapacitetet organizative, aftësitë organizative për të zbatuar kontratën, reputacionin dhe besueshmërinë duke qenë se kontrata është komplekse me shumë artikuj të cilat duhet të transportohen dhe të bëhet furnizim vendosja e tyre sipas shkollave të përcaktuara.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mobilje për shkollat e qytetit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*